TERMAT E REFERENCËS

Projekti: "Qasje e Përbashkët drejt Ekonomisë Qarkulluese Blu për Rajonin Adriatik dhe Jon" (JOINt approAch to Blue circuLar Economy for Adriatic and Ionian Region) – JOINABLE

Programi Interreg IPA ADRION – IPA-ADRION00294

Thirrje për ofertë

Shërbim ekspertize të jashtme: "Nga mbetjet te produktet" (Waste to Product)

Dorëzimi D.3.1.3 – Products from waste

Autoriteti Kontraktues	Bashkia Divjakë, partnere e projektit JOINABLE (PP9)
Lloji i kontratës	Kontratë shërbimi (ekspertizë e jashtme) me vlerë totale të fiksuar
Linja buxhetore	External expertise and services – "Waste to product"
Aktiviteti / Dorëzimi	Aktiviteti 3.1 – Dorëzimi D.3.1.3 Products from waste
Fillimi i shërbimit	Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës
Përfundimi	Dorëzimi final jo më vonë se **15 Janar 2027**
Afati i fundit i aplikimit	**12/10/2026, ora 10:00**

1. Informacion i përgjithshëm

Projekti JOINABLE është një projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit Interreg IPA ADRION, që bashkon nëntë partnerë nga gjashtë vende të ndryshme (Itali, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëri dhe Greqi). Projekti synon të krijojë dhe të promovojë një ekonomi qarkulluese blu, duke adresuar sfidën e vazhdueshme të mbetjeve detare dhe të ujërave të ëmbla në rajonin Adriatiko-Jon.

Projekti ndjek një qasje me shumë nivele, që përfshin:

- analizën e kuadrit ligjor dhe politik;
- zhvillimin e planeve të përbashkëta të veprimit dhe strategjive;
- veprime pilot dhe demonstrim që shndërrojnë mbetjet në produkte;
- zhvillimin e planeve të biznesit për NVM-të;
- krijimin e një salle ekspozite dhe të materialeve të komunikimit për të shfaqur produktet dhe zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese.

Bashkia Divjakë, si partnere e projektit (PP9), ka për detyrë të realizojë, në kuadër të Paketës së Punës 3 (Pilot dhe demonstrim nga mbetjet te produktet), dorëzimin **D.3.1.3 – Products from waste**: gjashtë (6) produkte të ndryshme që do të prodhohen nga mbetjet e mbledhura (shporta, kosha, çanta, karrige, tavolina, rafte), për t'u dorëzuar në muajt 25–30 të projektit.

Për këtë qëllim, Bashkia Divjakë kërkon një ekspert ose kompani të specializuar (në vijim "Kontraktuesi") që do të ofrojë shërbimin e ekspertizës së jashtme "Waste to Product". Kjo thirrje zbatohet sipas parimeve dhe rregullave të Udhëzuesit Praktik të BE-së për prokurimin dhe grantet e veprimeve të jashtme (PRAG): transparencë, barazi trajtimi, mosdiskriminim, konkurrencë e drejtë dhe shmangie e konfliktit të interesit.

2. Objektivat e shërbimit

Objektivi i përgjithshëm është që mbetjet plastike të mbledhura në kuadër të projektit të shndërrohen në produkte të dobishme, të sigurta dhe të qëndrueshme, duke demonstruar zinxhirin e vlerës "nga mbetja te produkti" në nivel lokal. Në mënyrë specifike, Kontraktuesi do të:

- karakterizojë dhe klasifikojë mbetjet plastike të mbledhura, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për çdo lloj produkti;
- projektojë deri në gjashtë (6) produkte të ndryshme, funksionale, të sigurta, të qëndrueshme dhe të riciklueshme në fund të kontratës;
- prodhojë dhe dorëzojë produktet përfundimtare në përputhje me dosjen teknike të miratuar;
- dokumentojë procesin në mënyrë që ai të jetë i përsëritshëm nga partnerët e tjerë dhe nga NVM-të lokale, dhe të mbështesë dorëzimet e tjera të WP3: D.3.1.2 (Report on pilot actions from waste to product), D.3.2.1 (Products inventory report), D.3.2.3 (Video) dhe D.3.3.2 (Demonstration of business cases).

3. Detyrat e kontraktuesit

Kontraktuesi kryen detyrat e mëposhtme:

3.1 Plani i punës

Hartimi i planit të detajuar të punës, i kalendarit dhe i kërkesave për lëndën e parë (lloji, sasia, gjendja e mbetjeve) në koordinim me Bashkinë.

3.2 Përgatitja e lëndës së parë

- Vlerësimi i mbetjeve plastike të mbledhura: identifikimi i llojeve të polimereve, shkalla e ndotjes dhe e degradimit, përshtatshmëria për përpunim. Kur është e disponueshme, mund të përdoret pajisja e projektit për identifikim (spektrometri) që mundësohet nga Bashkia.
- Ndarja, pastrimi dhe përgatitja e mbetjeve për përpunim (p.sh.grirje), me menaxhim të përshtatshëm të mbetjeve dytësore.

- Përcaktimi, në bazë të cilësisë dhe sasisë së mbetjeve, i llojeve të produkteve që janë teknikisht të realizueshme (deri në 6).

3.3 Dizajni i produkteve

- Dizajni i deri në gjashtë (6) produkteve: shporta, kosha, çanta, karrige, tavolina, rafte. Lista është indikative; përfundimtarja miratohet nga Bashkia në përfundim të detyrës 3.2, në varësi të cilësisë së mbetjeve.
- Dizajni ndjek parimet e ekonomisë qarkulluese: përdorim maksimal i materialit të ricikluar, qëndrueshmëri, mundësi riparimi, përdorim i një polimeri të vetëm ku është e mundur dhe në fund riciklimi.
- Dosja e dizajnit përfshin vizatime/skica, specifikime materiali, procesin e prodhimit dhe përdorimin e synuar.

3.4 Prototipet dhe testimi

Prodhimi i prototipeve (ose modeleve) dhe testimi i tyre për qëndrueshmëri, stabilitet dhe siguri përdorimi, sipas standardeve përkatëse evropiane kur zbatohen. Prodhimi final fillon vetëm pas miratimit nga Bashkia.

3.5 Prodhimi i produkteve finale

- Prodhimi i të paktën një (1) njësie funksionale për çdo lloj produkti të miratuar; sasitë shtesë propozohen nga ofertuesi brenda vlerës maksimale të deklaruar më sipër (Aneksi A, pjesa B).
- Çdo produkt shënjohet me kod unik identifikimi dhe numër loti për gjurmueshmëri dhe për pasaportën e produktit.
- Dorëzimi i produkteve në vendin e caktuar nga Bashkia në Shqipëri dhe transporti përfshihet në shumën e deklaruar më sipër.

3.6 Dokumentimi

- Fletë teknike për çdo produkt: përbërja e materialit dhe përqindja e materialit të ricikluar, sasia e mbetjeve të përdorura (kg), dimensionet, pesha, procesi, rezultatet e testeve, udhëzime përdorimi dhe mirëmbajtjeje.
- Regjistër gjurmueshmërie: origjina e lëndës së parë (sipas të dhënave të siguruara nga Bashkia), datat dhe lotet e prodhimit.
- Bilanci i masës: kg mbetje në hyrje, kg produkte dhe kg mbetje dytësore.
- Material fotografik me cilësi të lartë dhe klipe të shkurtra video të procesit, të përshtatshme për videon e projektit (D.3.2.3).

3.7 Transferimi i njohurive dhe mbështetja për rezultatet e tjera të projektit

- Një (1) sesion (në prani ose online, deri në 3 orë) për stafin e Bashkisë, aktorët lokalë dhe NVM-të, mbi procesin dhe mundësitë e përsëritjes.

- Ofrimi i të dhënave të kostos dhe të procesit (materiale, energji, punë, rendiment) që shërbejnë për rastet e biznesit dhe planin e biznesit për NVM-të (D.3.3.1, D.3.3.2).
- Koordinimi me ekspertin e Pasaportës së Produktit (thirrje e veçantë e Bashkisë): sigurimi i të dhënave të nevojshme për pasaportën e çdo produkti.

4. Kërkesa teknike dhe cilësore

- **Siguria e produkteve.** Produktet duhet të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorimin e synuar (pa skaje të mprehta, pa rrezik përmbysjeje apo thyerjeje). Produktet nuk deklarohen të përshtatshme për kontakt me ushqimin.
- **Substancat.** Kontraktuesi deklaron aditivët, pigmentet dhe stabilizuesit e përdorur dhe i kufizon ato në minimumin e nevojshëm; nuk lejohen substanca të rrezikshme të ndaluara nga legjislacioni në fuqi.
- **Materiali i ricikluar.** Përmbajtja e materialit të ricikluar nga mbetjet e projektit maksimizohet dhe deklarohet për çdo produkt. Ofertuesi propozon përqindjen minimale të garantuar (Aneksi A, pjesa B).
- **Menaxhimi i mbetjeve dhe siguria në punë.** Kontraktuesi është përgjegjës për lejet dhe autorizimet e nevojshme për transportin dhe përpunimin e mbetjeve sipas legjislacionit shqiptar, për sigurinë në punë dhe për trajtimin e duhur të mbetjeve dytësore.
- **Standardet.** Aty ku ekzistojnë standarde evropiane për kategorinë e produktit (p.sh. mobilje), Kontraktuesi i përmend dhe i zbaton ato për testimin; ku nuk zbatohen, përshkruan kriteret e vetëtestimit.

5. Produktet e dorëzueshme dhe afatet kohore

Afatet janë llogaritur nga data e nënshkrimit të kontratës. Afati final është i pandryshueshëm.

Nr.	Produkti i dorëzueshëm	Përmbajtja	Afati
R1	Raporti fillestar dhe plani i punës	Metodologjia e detajuar, kalendari, ekipi, lista paraprake e produkteve, kërkesat për lëndën e parë	10 ditë kalendarike nga nënshkrimi
R2	Raporti i karakterizimit të lëndës së parë dhe dosja e dizajnit	Rezultatet e klasifikimit të mbetjeve, lista përfundimtare e produkteve (deri në 6), vizatime dhe specifikime teknike	30 ditë kalendarike nga nënshkrimi
R3	Prototipet dhe raporti i testimit	Prototipe funksionale (ose modele) dhe rezultatet e testeve; miratimi i Bashkisë përpara prodhimit final	60 ditë kalendarike nga nënshkrimi, jo më vonë se 1 janar 2027
R4	Produktet finale dhe raporti përfundimtar	Produktet finale, fletët teknike, regjistri i gjurmueshmërisë, bilanci i masës, foto dhe video, të dhënat e kostos, sesioni i transferimit të njohurive	Jo më vonë se 15 Janar 2027

Përgjegjësitë e Bashkisë Divjakë: siguron mbetjet plastike të mbledhura në kuadër të projektit dhe të dhënat për origjinën e tyre (vendi, data, aktiviteti); miraton produktet e dorëzueshme brenda afateve të pikës 10 dhe lehtëson komunikimin me partnerët e projektit.

6. Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar

Kërkesa të detyrueshme:

- Person juridik ose person fizik me veprimtari të regjistruar (me NIPT).
- Kapacitet teknik: akses (në pronësi, me qira ose me partner të deklaruar) në pajisje për përpunimin e plastikës (p.sh. grirje, larje, ekstruzion, injektim, presim ose teknologji ekuivalente) dhe në hapësirë prodhimi.
- Ekipi minimal: (i) udhëheqës ekipi – Njohuri te mira me materialet kimike, mjedisore, dizajn industrial ose fushë të ngjashme, (ii) dizajner/projektues produkti – (iii) specialist prodhimi/teknolog – . I njëjti person mund të mbulojë më shumë se një rol nëse justifikohet.
- Aftësi të mira në gjuhën angleze (e shkruar), për raportim.

Të dëshirueshme:

- Përvojë në dizajnin dhe/ose prodhimin e produkteve nga plastika e ricikluar ose në përpunimin e mbetjeve plastike.
- Njohje e mbetjeve detare dhe të ujërave të ëmbla dhe e ekonomisë blu.
- Përvojë në modele biznesi për NVM-të në fushën e riciklimit.

7. Pranueshmëria, përjashtimi dhe konflikti i interesit

Pranueshmëria. Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që plotësojnë rregullat e kualifikueshmërisë (kombësia dhe origjina) të përcaktuara në PRAG dhe në rregullat e Programit Interreg IPA ADRION.

Përjashtimi. Ofertuesit nuk duhet të ndodhen në asnjë nga situatat e përjashtimit të parashikuara nga PRAG, përfshirë: falimentimin ose likuidimin; shkeljet e rënda profesionale; mospagimin e taksave ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore; mashtrimin, korrupsionin, pjesëmarrjen në organizatë kriminale ose pastrimin e parave; si dhe deklarimin e rremë gjatë procedurës. Mospërjashtimi vërtetohet me Deklaratën e Nderit (Aneksi B). Ofertuesit të shpallur fitues mund t'i kërkohet të paraqesë dokumente provuese (p.sh. vërtetime tatimore, të sigurimeve shoqërore dhe të gjendjes gjyqësore) brenda afatit që përcakton Bashkia.

Konflikti i interesit. Nuk mund të marrin pjesë në procedurë dhe as të kontraktohen: (a) punonjësit e Bashkisë Divjakë dhe të partnerëve të projektit JOINABLE, si dhe të afërmit e tyre; (b) personat ose subjektet që kanë qenë të përfshirë në përgatitjen e këtij ToR ose të aplikimit të projektit në mënyrë që u jep avantazh të padrejtë; (c) subjektet me interesa të tjera që cenojnë paanësinë e ekzekutimit të kontratës. Çdo situatë e mundshme konflikti duhet të deklarohet menjëherë.

8. Aplikimi dhe përmbajtja e ofertës

Ekspertët dhe kompanitë e interesuara ftohen të paraqesin ofertën me dokumentet e mëposhtme:

Për kompanitë (persona juridikë):

- Dokumenti i regjistrimit (NIPT/NUIS).
- Profili i kompanisë dhe lista e referencave të ngjashme (klienti, viti, vlera, përshkrimi, kontakti).
- CV e anëtarëve kyç të ekipit.
- Oferta teknike .
- Oferta financiare dhe tabela e produkteve/sasive (Aneksi A).
- Deklarata e Nderit (Aneksi B), e nënshkruar.

Për personat fizikë:

- Dokumenti i regjistrimit (NIPT/NUIS).
- CV e detajuar, dhe dokumenti i regjistrimit të veprimtarisë.
- Oferta teknike.
- Oferta financiare dhe tabela e produkteve/sasive (Aneksi A) dhe Deklarata e Nderit (Aneksi B).

Kushtet e dorëzimit:

Oferta dorëzohet në gjuhën shqipe dhe angleze, me email në adresën esmeralda.harizi@bashkiadivjake.gov.al me subjekt "Shërbim ekspertize të jashtme – Waste to Product (D.3.1.3)".

- Vlerat shprehen në Euro. Vlera totale e fiksuar përfshin të gjitha kostot dhe taksat, duke përfshirë TVSH-në. Oferta që tejkalon vlerën maksimale të kontratës refuzohet.
- Oferta mbetet e vlefshme për 90 ditë kalendarike nga afati i fundit i dorëzimit.
- Një ofertues mund të paraqesë vetëm një ofertë për këtë thirrje. Ofertat në formate të ndryshme nga këto terma reference nuk pranohen.
- **Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: Data12/10/2026 ora 10:00.** Ofertat e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në konsideratë.
- **Pyetjet dhe sqarimet:** paraqiten me shkrim deri më datë 05/10/2026 në esmeralda.harizi@bashkiadivjake.gov.al .
- Përgjigjet publikohen për të gjithë të interesuarit në faqen ku është publikuar ky ToR, pa identifikuar pyetësin.
- Ky ToR publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Divjakë.

9. Vlerësimi i ofertave dhe dhënia e kontratës

Ofertat vlerësohen nga një Komision Vlerësimi i ngritur nga Bashkia Divjakë, me tre (3) anëtarë. Anëtarët nënshkruajnë formularët e deklarimit për konflikt interesi. Vlerësimi kryhet në këto hapa:

- **Hapi 1 – Kontrolli administrativ.** Kontrollohet plotësia e dokumenteve, pranueshmëria dhe mospërjashtimi (seksioni 7). Ofertat që nuk plotësojnë kërkesat e detyrueshme ose që tejkalojnë vlerën maksimale refuzohen.

- **Hapi 2 – Vlerësimi teknik (100 pikë).** Sipas tabelës më poshtë. Ofertat që marrin më pak se 70 pikë refuzohen dhe nuk kalojnë në vlerësimin financiar.
- **Hapi 3 – Vlerësimi financiar (100 pikë).** Pikët financiare = (Vlera më i ulët i ofertës së pranueshme ÷ Vlera i ofertës në shqyrtim) × 100.
- **Hapi 4 – Rezultati final** = 70% × pikët teknike + 30% × pikët financiare. Kontrata i jepet ofertës me rezultatin final më të lartë.

Kriteri i vlerësimit teknik	**Çfarë vlerësohet**	**Pikë**
1. Përvoja dhe referencat	Numri, vlera dhe përputhshmëria e projekteve të ngjashme në 5 vitet e fundit; përvoja në projekte të financuara nga BE	30
2. Metodologjia dhe plani i punës	Kuptimi i ToR, qasja për karakterizimin e mbetjeve, konceptet paraprake të produkteve, kontrolli i cilësisë dhe i sigurisë, menaxhimi i rreziqeve, realizmi i kalendarit.	35
3. Ekipi dhe kualifikimet	Arsimimi, përvoja dhe përshtatshmëria e udhëheqësit të ekipit, dizajnerit dhe specialistit të prodhimit.	25
4. Kapaciteti teknik dhe qarkullueshmëria	Pajisjet dhe hapësirat e prodhimit; përmbajtja e propozuar e materialit të ricikluar; dizajn për riparim dhe riciklim	10
TOTALI		**100**

Në rast barazimi të rezultatit final, përparësi ka oferta me pikët teknike më të larta. Ofertuesve me vlerë jashtëzakonisht të ulët mund t'u kërkohet të arsyetojnë vlerën e propozuar. Komisioni mund të kërkojë sqarime me shkrim gjatë vlerësimit, pa lejuar ndryshimin e thelbit të ofertës. Rezultati u komunikohet me email të gjithë ofertuesve. Bashkia rezervon të drejtën të anulojë procedurën, me arsyetim, nëse nuk merret asnjë ofertë e pranueshme ose nëse ndryshojnë rrethanat e projektit. Kontrata nënshkruhet me ofertuesin fitues pas përfundimit të procedurës.

10. Raportimi dhe pranimi i punës

Kontraktuesi raporton drejtpërdrejt te Menaxheri i Projektit të Bashkisë Divjakë dhe punon në koordinim me Partnerin Udhëheqës dhe me partnerët e tjerë të projektit sipas nevojës. Për ndjekjen e progresit planifikohen takime virtuale koordinimi, të paktën një në muaj.

- Çdo produkt i dorëzueshëm dorëzohet me shkrim, në formë elektronike. Bashkia e shqyrton brenda 10 ditëve të punës dhe e miraton, e kthen me komente ose e refuzon me arsyetim; Kontraktuesi bën korrigjimet brenda 5 ditëve të punës.
- Pranimi i çdo produkti të dorëzueshëm dokumentohet me procesverbal pranimi të nënshkruar nga të dyja palët.
- Dokumentet e dorëzueshme hartohen në gjuhën angleze, me përmbledhje ekzekutive në shqip, pasi shërbejnë për raportimin drejt Partnerit Udhëheqës dhe Programit.

11. Financimi dhe pagesat

Pagesa për shërbimin e kryer do të realizohet në dy faza pas përfundimit të suksesshëm të shërbimit sipas tabelës në seksionin nr.5, në llogarinë bankare të subjektit sipas dakordësisë dhe kushteve të vendosura në kontratën e lidhur me Bashkinë Divjakë.
Pagesat do të kryhen në monedhën kombëtare **Lek (ALL)**, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e lëshimit të faturës/kërkesës për pagesë.

12. Vizibiliteti, pronësia intelektuale, auditimi dhe kushte të tjera

- **Vizibiliteti.** Të gjitha dokumentet e dorëzueshme dhe, ku është teknikisht e mundur, produktet fizike, shënjohen me emblemën e Bashkimit Evropian dhe deklaratën e bashkëfinancimit, me logon e Programit Interreg IPA ADRION dhe atë të projektit JOINABLE, sipas udhëzimeve të vizibilitetit të Programit që Bashkia ia vë në dispozicion Kontraktuesit.
- **Pronësia intelektuale.** Dizajnet, dosjet teknike, dokumentacioni dhe materialet audiovizive të prodhuara në kuadër të kontratës u përkasin Bashkisë Divjakë dhe partnerëve të projektit, të cilët kanë të drejtën e përdorimit dhe të riprodhimit të tyre pa kufizim kohor për qëllimet e projektit dhe të përsëritjes së pilotit. Kontraktuesi ruan njohuritë e mëparshme (pre-existing know-how) dhe përgjegjësinë që dizajnet nuk cenojnë të drejtat e palëve të treta.
- **Auditimi dhe kontrolli.** Kontraktuesi pranon që Programi Interreg IPA ADRION, Komisioni Evropian, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe autoritetet kombëtare kompetente kanë të drejtë të kontrollojnë dhe të audititojnë ekzekutimin e kontratës dhe dokumentacionin përkatës. Dokumentacioni ruhet për afatet e përcaktuara në kontratë dhe në rregullat e Programit.
- **Konfidencialiteti.** Kontraktuesi nuk i publikon dhe nuk i përdor informacionet e marra gjatë ekzekutimit të kontratës për qëllime të tjera, pa miratimin me shkrim të Bashkisë.
- **Nënkontraktimi.** Lejohet vetëm pjesërisht dhe me miratim paraprak me shkrim të Bashkisë. Kontraktuesi mbetet plotësisht përgjegjës, dhe nënkontraktorët i nënshtrohen të njëjtave rregulla kualifikueshmërie dhe përjashtimi.
- **Etika.** Kontraktuesi nuk ofron dhe nuk pranon dhurata apo përfitime që mund të ndikojnë në procedurë ose në ekzekutimin e kontratës.
- **Ligji i zbatueshëm.** Kontrata rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe nga rregullat e Programit. Mosmarrëveshjet zgjidhen fillimisht me negociim dhe, në rast dështimi, nga gjykatat kompetente shqiptare. Penalitetet për vonesa dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës përcaktohen në kontratë.

13. Shënim

Ky dokument i Termave të Referencës bazohet në dokumentacionin e projektit JOINABLE (IPA-ADRION00294) dhe mund t'i nënshtrohet rregullimeve në konsultim me Partnerin Udhëheqës dhe Programin. Çdo ndryshim thelbësor publikohet për të gjithë të interesuarit përpara afatit të fundit të aplikimit.

ANEKSI A
OFERTA FINANCIARE

Shërbim ekspertize të jashtme – Waste to Product (D.3.1.3)

Ofertuesi: [emri i kompanisë / personit fizik] **NIPT:** [NIPT]

Pjesa A – Vlera (në Euro)

Nr.	Zëri	Shuma (EUR)
1	Karakterizimi i lëndës së parë, dizajni dhe dosja teknike (R1–R2)	
2	Prototipet dhe testimi (R3)	
3	Prodhimi i produkteve finale, transporti dhe dorëzimi (R4)	
4	Dokumentimi, raportimi dhe sesioni i transferimit të njohurive (R4)	
	TOTALI	

Pjesa B – Produktet dhe sasitë e propozuara

Lloji i produktit	Sasia e propozuar (njësi)	Mbetje plastike e vlerësuar (kg)	Përmbajtja e ricikluar e garantuar (%)
Shportë			
Kosh			
Çantë			
Karrige			
Tavolinë			
Raft			

Ofertuesi mund të propozojë më pak lloje produktesh nëse arsyetohet nga cilësia e pritshme e mbetjeve. Numri përfundimtar konfirmohet nga Bashkia në R2; çdo ndryshim që ndikon vlerën rregullohet me shtojcë kontrate, brenda vlerës maksimale.

Vendi dhe data: _____ Nënshkrimi dhe vula: _____

ANEKSI B
DEKLARATË NËN PËRGJEGJËSINË PERSONALE (DEKLARATË NDERI)

Shërbim ekspertize të jashtme – Waste to Product (D.3.1.3)

Unë, i/e nënshkruari/a [emri dhe mbiemri], në cilësinë e [pozicioni / person fizik] të [emri i ofertuesit], me NIPT [NIPT], deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- **Kualifikueshmëria.** Ofertuesi plotëson rregullat e kualifikueshmërisë (kombësia dhe origjina) të PRAG dhe të Programit Interreg IPA ADRION dhe ka aftësinë ligjore për të ushtruar veprimtarinë objekt i kontratës.
- **Mospërjashtimi.** Nuk ndodhem në asnjë nga situatat e përjashtimit: falimentim, likuidim ose pezullim të veprimtarisë; dënim me vendim të formës së prerë për vepër penale që lidhet me veprimtarinë profesionale, mashtrim, korrupsion, pjesëmarrje në organizatë kriminale ose pastrim parash; shkelje të rëndë profesionale; mospërmbushje të detyrimeve për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore; deklarim të rremë gjatë procedurave të prokurimit.
- **Konflikti i interesit.** Nuk jam në konflikt interesi; nuk jam punonjës i Bashkisë Divjakë apo i partnerëve të projektit JOINABLE dhe as i afërm i tyre; nuk kam qenë i përfshirë në përgatitjen e këtij ToR në mënyrë që të përfitoj avantazh të padrejtë.
- **Vërtetësia.** Informacionet dhe dokumentet e paraqitura në ofertë janë të plota dhe të vërteta.
- **Kontrolli.** Pranoj kontrollet dhe auditimet e parashikuara në ToR dhe pranoj që deklarimi i rremë çon në përjashtim nga procedura dhe në sanksionet e parashikuara në ligj dhe në kontratë.
- **Ndryshimet.** Do ta njoftoj menjëherë Bashkinë Divjakë për çdo ndryshim të rrethanave të mësipërme.

Vendi dhe data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi dhe vula: _____